

**Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të
Planit të Integritetit 2024
Bashkia Shijak**

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje	3
II.	Metodologjia e vlerësimit	4
III.	Monitorimi i zbatueshmërisë të planit të integritetit	4
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.6
V.	Hapa të tjerë.....	16

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	5
Figura 2; Grafiku i zbatimit të masave janar-dhjetor 2024.....	6
Figura 3: Objektivi I “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	8
Figura 4 : Objektivi II “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	9
Figura 5 : Objektivi III “Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	11
Figura 6 : Objektivi IV “Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	13
Figura 7 : Objektivi V “Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	15

I. Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti nënkupton përmbushjen e detyrimeve për transparencë, llogaridhënie, etikë, ndershmëri, efektivitet dhe efikasitet në kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e funksioneve rregullatore dhe administrative.

Në nivelin e qeverisjes vendore, zbatimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit është konkretizuar përmes koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023, e cila vijon me Strategjinë e re 2024-2030 dhe Planin e Veprimit 2024-2026, të miratuara me Vendimin nr. 859, datë 26.12.2024.

Menaxhimi i riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) përfaqëson një proces të rëndësishëm, i cili mbështetet në a Qëllimin e parë të Politikës: Parandalimi i korrupsionit, dhe konkretizohet në Objektivin Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces kontribuon gjithashtu në realizimin e Qëllimit Politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2023 (SNDQV): “Forcimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor, Objektivin Specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023.

Ky proces është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, ku ndër rekomandimet e dhëna theksohet zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional për menaxhimin e integritetit në institucionet publike të vendit.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor zbatohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Hapi i parë i këtij procesi është hartimi i Planit të Integritetit për njësinë vendore, detajuar edhe me një Plan Veprimi trevjeçar. Monitorimi dhe raportimi i këtij plani përbëjnë etapën tjetër të menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi zhvillohet periodikisht (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga punonjësit dhe drejtuesit e bashkisë për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata mbajnë.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar procesin e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie për vitin 2024.

II. Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar sipas metodologjisë së miratuar me **Urdhrin nr.553, datë 30.09.2021**, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”. Vlerësimi është realizuar nëpërmjet analizës së të dhënave dhe matjes së progresit në zbatimin e masave të përfshira në Planin e Veprimit për këtë periudhë raportimi.

III. Monitorimit i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2024.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Shijak për vitin 2024 përbën dokumentin e tretë të hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 553, datë 30.09.2021.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej 5 objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit.
- **Objektivi II** Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
- **Objektivi III** Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit.
- **Objektivi VI** Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse.
- **Objektivi V** Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë.

Plani i Integritetit është konceptuar për t’u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2022-2025.

Për Bashkinë Shijak, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2024, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara.


Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Shijak për periudhën janar – dhjetor 2024, rezulton si më poshtë:

Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 31 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2024:

- 18 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 58% të totalit
- 10 masa/aktivitete janë në process realizimi, ose 32 %
- 3 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 10 %


Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Figura 1 : Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktiviteteteve janar-dhjetor 2024.



Bashkia Shijak	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të perealizuara
Realizimi ne total i objektivave të PI		31	18	10	3

Figura 2: Grafiku i zbatimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Sa më sipër, gjatë vitit 2024, Bashkia Shijak ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Qasja Vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të bashkisë përmban një analizë të përgjithshme mbi zbatueshmërinë dhe progresin e arritur gjatë vitit 2024, në lidhje me aktivitetet dhe masat për menaxhimin e riskut në fusha të veçanta të përgjegjësisë. Raporti vlerëson gjithashtu përputhshmërinë me kuadrin rregullator dhe ndikimin e masave të ndërmarra në përmirësimin e performancës institucionale dhe forcimin e kapaciteteve për të parandaluar dhe për të rezistuar ndaj shkeljeve të integritetit.

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë, bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2024, sipas Planit të Veprimit të Planit të Integritetit.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë mbledhur nga Koordinator i Integritetit të bashkisë, në përmbushje të rolit të tij si strukturë e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit”

Ky objektivi synon menaxhimin e riskut të integritetit me fokus në fushat e menaxhimit të pronave të bashkisë dhe planifikimit të territorit. Një menaxhim më i mirë i këtyre të fundit do të forconte ekonomikisht bashkinë dhe do të lejonte shfrytëzim më të mirë të pronave bashkiake nga subjektet ekonomike.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 2 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 50 %
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 50 %.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Objektivi	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përealizuara
I					
Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit		2	0	1	1

Figura 3: **Objektivi I** “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për këtë periudhë raportimi janar-dhjetor 2024, bashkia vijon të jetë në proces të realizimit;

- Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë për Administrimin e Pronave Bashkiake, duke marrë në konsideratë dhe planin dhjetëvjeçar të miratuar për Menaxhimin e Pronave të Bashkisë;

Objektivi II “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Ky objektivi synon përfundimin e procesit të menaxhimit të riskut në fushën e menaxhimit financiar dhe atë të kontrollit. Menaxhimi i mirë i financave vendore përmes përmirësimit të efikasitetit të proceseve financiare dhe kontrollit më të mirë të tyre, siguron më shumë të ardhura për bashkinë, duke rritur kështu potencialin ekonomik të saj.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 është planifikuar për t’u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet:

- Është realizuar masa/aktiviteti ose 100%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Objektivi II	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht tërealizuara	Masa dhe aktivitete te perealizuara
Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.		1	1	0	0

Figura 4: **Objektivi II** “Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit”,grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, objektivi është realizuar në masën **100%**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Sektori i Auditit të Brendshëm është plotësuar me 3 punonjës të certifikuar.

Objektivi III “Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit”

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik, menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 3 masa/aktivitete, nga të cilat:


- Janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 67 %
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 33 %.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të perealizuara
Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit”		3	2	0	1

Figura 5: **Objektivi III** “Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, objektivi është realizuar në masën **67%**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Identifikimi i proceseve të punës së bashkisë që kanë përparësi për hartimin e PSV-ve;
- Hartimi dhe miratimi i PSV-ve për proceset me rëndësi kritike të bashkisë ;

Objektivi IV “Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse”

Ky objektivi synon forcimin e procesit të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe të shërbimeve publike e mbështetëse në bashki, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në institucion, do të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme në kuadër të zbatimit dhe konsolidimit të mekanizmave garantuese të integritetit në institucion, me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe përmirësimin e integritetit të zyrtarëve.


Gjatë periudhës raportues, në kuadër të këtijobjektivi, për vitin 2024 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 25 masa/aktivitete, nga të cilat:

- Janë realizuar 15 masa/aktivitete ose 60 %
- Janë në proces realizimi 9 masa/aktivitete ose 36 %
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitetet ose 4 %.

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Objektivi IV	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të porealizuara
Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse		25	15	9	1

Figura 6: **Objektivi IV** “Përforcimi i integritetit institucional të bashkisë, përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe forcimit të shërbimeve publike dhe mbështetëse”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, ky objektivi është realizuar në masën **60%**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Hartimi dhe miratimi i një Plani të Specializuar të Veprimit (PSV) për koordinimin efektiv të punës ndërmjet drejtorive të bashkisë gjatë procesit të përgatitjes dhe miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- Formalizimi i detyrimit për shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional, përmes komunikimit zyrtar me shkrim ndërmjet drejtorive të përfshira në hartimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor;
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i stafit përgjegjës të bashkisë mbi përmbajtjen dhe qëllimin e PSV-së së miratuar;
- Informimi periodik i punonjësve të bashkisë lidhur me Kodin e Etikës së institucionit, me qëllim forcimin e integritetit dhe standardeve etike;
- Komunikimi i rregullt me stafin mbi rregullat e brendshme të komunikimit institucional, të përcaktuara në rregulloren e miratuar për këtë qëllim;
- Informimi i vazhdueshëm i stafit të bashkisë mbi njësinë përgjegjëse për konfliktin e interesit, regjistrin përkatës si dhe procesin për administrimin e rasteve të tilla;
- Ofrimi i trajnimeve specifike mbi kuadrin ligjor dhe procedurat lidhur me konfliktin e interesit, në përputhje me masën/aktivitetin 32/2 të planit përkatës;

- Informimi i stafit mbi Planin Vjetor të Trajnimeve, bazuar në analizën dhe identifikimin e nevojave të brendshme për zhvillim profesional;
- Rritja e transparencës institucionale përmes masave të brendshme informuese dhe qasjeve të hapura për komunikim ndërsektorial;
- Organizimi i takimeve të brendshme informuese me punonjësit mbi rolin, funksionet dhe proceset e Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
- Përcaktimi i qartë i pavarësisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë;
- Reflektimi i kësaj pavarësie në strukturën organizative (organigramën) e bashkisë;
- Ofrimi i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme për stafin, në lidhje me procesin e sinjalizimit të shkeljeve dhe mbrojtjes së sinjalizuesve;
- Publikimi i të dhënave të njesisë përgjegjëse për administrimin e sinjalizimeve, për të siguruar qartësi dhe akses të lehtë për punonjësit;
- Rikujtimi periodik i punonjësve për kontaktet dhe mënyrat e komunikimit me njësinë përgjegjëse për sinjalizime.

Objektivi V “Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë”

Ky objektivi, synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, nëpërmjet përmirësimit të proceseve rregulluese të konsultimeve publike, rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe zhvillimin e transparencës proaktive. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut dhe përfshirjen më të madhe të tij në veprimtarinë e bashkisë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 është planifikuar për t’u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet, nga të cilat:


- Është në proces realizimi 1 masë/aktivitet ose 100%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Objektivi V	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të perealizuara
Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë.		1	0	1	0

Figura 7 : Objektivi V “Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës së bashkisë, për rritjen e besimit dhe përfshirjes së qytetarëve ndaj veprimtarisë së bashkisë”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



IV. Konkluzione dhe Rekomandime.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese *janar-dhjetor 2024*, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se:

Bashkia Shijak ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel bazik realizimi prej 58% të masave të planifikuara për vitin 2024 (në intervalin 40-60%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë më e lartë në publikimin e informacioneve;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etiken institucionale;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së integritetit të institucionit. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontrolleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme në adresën zyrtare të bashkisë. Ky progres e ka ndikuar pozitivisht në krijimin e një kulture prointegritet dhe forcimin e besueshmërisë publike ndaj institucionit.

V. Hapa të tjerë:

- Zgjerimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuese, me fokus në parandalimin e sjelljeve që çënojnë integritetin;
- Forcimi i zbatimit të masave për transparencë dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, me synim rritjen e integritetit në menaxhimin financiar, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe administrimin e aseteve;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Të vijojë puna për hartimin dhe miratimin e strategjisë për administrimin e pronave të bashkisë;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;